



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
JURIA

Tiranë, më 04.04. 2017

151/  
2

Vendim

Nr. 10 datë 04.04. 2017

**Për shpalljen e fituesve të çmimeve shkencore kombëtare vjetore (2016), që akordohen nga Akademia e Shkencave**


Juria e çmimeve shkencore kombëtare që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më tej: ASHSH), e krijuar me Urdhrin nr. 4 datë 20.01.2017, Për ngritjen dhe përbërjen e jurisë së çmimeve shkencore kombëtare vjetore për vitin 2016, të Kryetarit të ASHSH akademik Muzafer Korkuti; në përmbushje të përgjegjësive të veta dhe referuar:

- Ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, neni 4, pika dh;
- Nenin 14 të Rregullores për themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, për mënyrën e organizimit të konkurseve, për kriteret e zgjedhjes së fituesve dhe mënyrën e shpalljes së tyre, miratuar me Urdhrin nr. 11, datë 6.10.2016;
- Vendimit nr. 5, datë 10.10.2016, Për shpalljen e organizimit të çmimeve shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për vitin 2016; neni 6 pika 4, neni 7 pika 4, neni 8, pika 4, neni 9 pika 4;
- Si dhe dokumentit *Thirrje për pjesëmarrje* në edicionin e parë të çmimeve shkencore kombëtare të ASHSH për vitin 2016:

Pas një procesi të gjatë diskutimi të frytshëm mbi vlerat e secilit prej punimeve dhe autorëve të nominuar, me votim të fshehtë, në mbledhjen e datës 10 mars 2017,

## Vendosi:

- 1.1. Të shpallë fitues të çmimit shkencor kombëtar vjetor *Eqrem Çabej*, që jepet për studimin më të mirë në fushën e shkencave shoqërore dhe albanologjike, prof. dr. Pëllumb Xhufin, autor i studimit monografik *Árbërit e Jonit*.
- 1.2. Fituesit të çmimit *Eqrem Çabej* t'i dorëzohet diploma me motivacionin, simboli i çmimit, si dhe një shpërblim në masën 1.000.000 lekë.
- 2.1. Të shpallë fitues të çmimit shkencor kombëtar vjetor *Petrít Radovicka*, që jepet për studimin më të mirë në fushën e shkencave natyrore dhe teknike, prof. dr. Niko Panon, autor i studimit monografik *Pasuritë ujore të Shqipërisë*.
- 2.2. Fituesit të çmimit *Petrít Radovicka* t'i dorëzohet diploma me motivacionin, simboli i çmimit, si dhe një shpërblim në masën 1.000.000 lekë.
- 3.1. Të shpallë fitues të çmimit shkencor të *Karrierës Akademike*, që jepet për merita shkencore të vijueshme me rëndësi për dijet kombëtare, akad. Idriz Ajetin.
- 3.2. Për fituesin e çmimit të *Karrierës Akademike*, të cilit diploma me motivacionin dhe simbolin e çmimit i është dorëzuar me një ceremoni publike mbështetur vendimit të ndërmjetëm të Jurisë, i jepet një shpërblim në masën 500.000 lekë.
- 4.1. Të shpallë fitues të çmimit shkencor kombëtar vjetor *Për kërkuesin e ri më të suksesshëm në shkencat shoqërore dhe albanologjike*, autorët Andi Rëmbeci dhe Sokol Çunga, me veprën *Katërrungjillëshi i dekoruar i Korçës*, studim tekstologjik dhe botim kritik.
- 4.2. Fituesve të çmimit *Për kërkuesin e ri më të suksesshëm në shkencat shoqërore dhe albanologjike* t'u dorëzohet diploma me motivacionin, si dhe një shpërblim në masën 500.000 lekë.
- 5.1. Të shpallë fitues të çmimit shkencor kombëtar vjetor *Për kërkuesin e ri më të suksesshëm në shkencat natyrore dhe teknike* z. Rigers Bakiu, me veprën *Molecular Evolution of Pyroglutamylated RFamide Peptide and Orphan G Protein Coupled Receptor*.
- 5.2. Fituesit të çmimit *Për kërkuesin e ri më të suksesshëm në shkencat natyrore dhe teknike* i dorëzohet diploma me motivacionin, si dhe një shpërblim në masën 500.000 lekë.
6. Ceremonia e dhënies së çmimeve organizohet më datën 21.04.2017, ora 11.00, me prani të të ftuarve nga autoritetet shkencore e publike dhe të mediave.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Kryetar i Jurisë

Akademik Muzafer Korkuti

Kryetar

